

MENAXHIMI I QËNDRUESHËM I UJIT PËRBALLË *Ndryshimeve Klimatike*

KONFERENCA DHE EKSPOZITA E 13-TE
E PËRBASHKËT BALLKANIKE



11-12-13 NËNTOR 2025
DURRËS, SHQIPËRI

Menaxhimi i qëndrueshëm i ujit në praktikë: Përvoja nga rehabilitimi i burimeve të ujit në Prizren

Demokrat Bytyçi
KRU "Hidroregjioni Jugor"SH.A

Durrës, 13.11.2025

Përmbajtja

Qëllimi i prezantimit	01
Konteksti	02
Burimi Sozi (Nashec)	03
Burimi “Kaptazha IV” – 40 Burimet	04
Rezultatet kryesore	05
Përfitimet dhe ndikimi	06
Sfidat dhe rekomandimet	07



Qëllimi i prezantimit


- Rehabilitimi i burimeve ekzistuese për **furnizim të qëndrueshëm**.
- Përmirësimi i **cilësisë së ujit** dhe reduktimi i humbjeve.
- Zbatimi i **praktikave të qëndrueshme** në menaxhimin e burimeve ujore.
- Forcimi i **kapaciteteve institucionale dhe ndërgjegjësimit** për ruajtjen e burimeve natyrore.
- Zhvillimi i zgjidhjeve afatgjata përmes integritit të **Planit të Sigurisë së Ujit (PSU)** dhe metodave moderne të monitorimit, për të garantuar furnizim të qëndrueshëm dhe të sigurt për komunitetet lokale.



Burimi Sozi (Nashec)

- Punime nga një kompani private e kontraktuar nga Komuna për **rregullimin e shtratit të lumit**.
- Gjatë devijimit të lumit, është hapur një **rrjedhë e re në anën e djathtë** me qëllim të devijimit të lumit.
- **Dëmtim i bazës së kaptazhës** dhe dalje e burimit nga struktura.
- Uji ka kaluar në lum, duke shkaktuar **humbje të mëdha dhe rënie të prurjes**.
- Ndërhyrja ishte e domosdoshme për rikthimin e funksionalitetit dhe stabilitetit të burimit.

*Ky dëmtim e bëri të domosdoshme **ndërhyrjen emergjente për rehabilitim**, me qëllim rikthimin e funksionalitetit të kaptazhës dhe **sigurimin e stabilitetit hidraulik të burimit** për furnizimin me ujë të pijshëm të zonave të varura nga ky sistem.*






Problemet e shkaktuara

- Dëmtimi i bazës së kaptazhës ka shkaktuar **daljen e ujit jashtë strukturës së kapjes dhe devijimin e rrjedhës drejt lumit.**

Si rezultat:

- Është humbur **kontrolli mbi prurjen natyrore të burimit.**
- Ka pasur **humbje të konsiderueshme të ujit të pijshëm**, që më parë kapeshin për furnizim.
- **Sasia e ujit të shfrytëzueshëm ka rënë nga rreth 60 l/s në vetëm 15-20 l/s.**
- Është krijuar **rrezik për ndotje** si pasojë e përzierjes së ujit të burimit me ujërat e sipërfaqës.
- Është **vështirësuar furnizimi i qëndrueshëm me ujë** për rreth **14 fshatra** që varen nga ky burim.
- Në thelb, ky dëmtim ka **komprometuar funksionin hidroteknik të kaptazhës** dhe ka cenuar sigurinë e furnizimit me ujë të pijshëm në zonën e Hasit dhe Prizrenit.





1. Kaptazha Ekzistuese “Sozi”

- e dëmtuar
- rrjedhje në lumë

2. Stacioni i pompave “Sozi”

- 6 pompa ekzistuese
- 3 aktive
- 3 pasive

3. Penda nga arxhila

- Komplet nga materiali arxhilës
- Thellësi 4m
- Gjerësi 4 m
- Gjatësi 20 m

1. Penda nga arxhila

20 m

4 m

Mbushje

Mbushje

2. Mbushja me arxhilë



Sfidat dhe përfundimet – Projekti I

Sfidat:

- Vendndodhja afër lumit dhe erozioni i shtratit e bënë punën teknike të vështirë.
- Prania e ujit gjatë punimeve kërkoj devijim dhe izolim të përkohshëm.
- Dëmtimi i bazës së kaptazhës kërkoj rindërtim të plotë me kujdes të veçantë.
- Kufizime në përdorimin e pajisjeve të rënda për shkak të terrenit.


Përfundimet:

- Rikthyer prurja natyrore në rreth **60+ L/s**, duke siguruar furnizim të qëndrueshëm për **14 fshatra**.
- **Eliminim i humbjeve** dhe stabilizim i rrjedhës së ujit brenda kaptazhës.
- **Izolim me arxhilë** për mbrojtje afatgjatë nga infiltrimi dhe erozioni.
- Shembull i mirë i **menaxhimit të qëndrueshëm dhe ripërtëritjes së burimeve ujore**.
- **Kapërderdhje e burimit**



Kaptazha IV – 40 Burimet

- Kaptazha e ndertuar për herë të parë në vitet e 60-ta.
- **Dëmtim i bazës së kaptazhës** dhe dalje e burimit si pasojë e erozionit të lumit
- Uji ka kaluar në lum, duke shkaktuar **humbje**.
- Ndërhyrja ishte e domosdoshme për rikthimin e funksionalitetit dhe stabilitetit të burimit.



Problemet e shkaktuara

- Dëmtimi i bazës së kaptazhës ka shkaktuar **daljen e ujit jashtë strukturës së kapjes dhe devijimin e rrjedhës drejt lumit.**

Si rezultat:

- Është humbur **kontrolli mbi prurjen natyrore të burimit.**
- Ka pasur **humbje të konsiderueshme të ujit të pijshëm**, që më parë kapeshin për furnizim.
- **Sasia e ujit të shfrytëzueshëm ka rënë në vetëm 50 l/s.**
- Është krijuar **rrezik për ndotje** si pasojë e përzierjes së ujit të burimit me ujërat e sipërfaqës.
- Është **vështirësuar furnizimi i qëndrueshëm me ujë për qytetin e Prizrenit** që varen nga ky burim.



Devijimi i
lumit

Uji nga burimi
pas gërmimit

Rrjedhjet në trasenë e burimit “Komora IV-të”

Rrjedhje



Rrjedhje



Rrjedhje



Rrjedhjet e evidentuara në trasenë e burimit kanë shkaktuar **humbje të konsiderueshme prej rreth 50 l/s**, duke bërë që **sasia e ujit të kapur të derdhej drejtpërdrejt në lum**.

Si pasojë, është cenuar **stabiliteti hidraulik** dhe **furnizimi i qëndrueshëm për konsumatorët**, duke e bërë të domosdoshme ndërhyrjen për **riparimin dhe izolimin e strukturës ekzistuese të kaptazhës** për të ndaluar rrjedhjet dhe rikthyer prurjen e plotë të ujit në sistem.





Muri
mbrojtës



Mbushja
me arxhilë

Sfidat dhe përfundimet – Projekti II

Sfidat:

- Kaptazha e ndërtuar në vitet '60, me **amortizim të theksuar strukturor**.
- **Rrjedhje të konsiderueshme (rreth 50 L/s)** që derdeshin drejtpërdrejt në lum.
- **Erozioni i shtratit të lumit** ka dëmtuar bazën e kaptazhës dhe ka devijuar ujërat.
- Vështirësi teknike për shkak të **pranisë së ujit gjatë punimeve** dhe terrenit të kufizuar për pajisje të rënda.

Përfundimet:

- **Ndalar rrjedhjet dhe rikthyer prurja e plotë e ujit në sistem.**
- **Rikthyer stabiliteti hidraulik** dhe siguria e furnizimit me ujë të pijshëm për zonën e Prizrenit.
- Zbatimi i **izolimit me arxhilë dhe ndërtimi i murit mbrojtës** kanë garantuar mbrojtje afatgjatë nga infiltrimi dhe erozioni.
- Projekti përfaqëson **praktikë të qëndrueshme të menaxhimit të burimeve ujore** dhe model për ndërhyrje rehabilituese në burime të vjetra.





Faleminderit!

Kontakt:

Demokrat Bytyçi

Shef i Sektorit të GIS - it

KRU "Hidroregjioni Jugor " Sh.A



+383 (0) 45 121 300



Demokrat.bytyqi@hidroregjioni-jugor.com